

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-96/2015

Prishtinë,

20 shtator 2017

Në çështjen juridike të:

M (S) P.

Pala ankuese

vs.

Askush

Pala Përgjegjëse

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov Gjyqtar i EULEX-it dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/R/247/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA21668) i datës 18 Qershor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 20 shtator 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si pabazuar ankesa e M. P. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/247/2014, i datës 18 Qershor 2014.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/247/2014, i datës 18 Qershor 2014, për sa i përket lëndës KPA21668.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 27 Gusht 2007 M. P. në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon ri-posedimin e banesës njëdhomëshe, sipas preendimit të tij pronë e babait të tij tani i ndjerë, që gjendej në rrugën “Cara Dušana” Nr.79,kati II, banesa Nr.5, me sipërfaqe prej 53 metra katrorë, (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA21668.
2. Pala ankuese pretendon se babai i tij i ndjerë S. P, tani i ndjerë e ka fituar të dretën e pronësisë me blerje në vitin 1993 nga Qeveria e Rpublikës së Serbisë.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Kontratë shitblerje Ov. Nr. 11473/93 datë 16 Dhjetor 1993 e lidhur në mes të Republikës së Serbisë si shitës dhe babait të palës ankuese, si blerës, në Gjykatën e dytë komunale në Beograd;
 - Certifikatë vdekje e lëshuar nga komuna paralele e Deçanit e dislokuar në Jagodina në Serbi me 21 Shtator 2007 që dëshmon se S. P. ka ndrruar jetë me 2 Mars 1998;
 - Një skicë e vizatuar me dorë për vendndodhjen e pronës së kërkuar.
 - Letërnjoftim i palës ankuese i lëshuar me 29 janar 2007 nga autoritetet paralele të Serbisë.
4. Më 30 Janar 2008, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një afishe në pronën e kërkuar dhe ka gjetur se prona është e zbrazët dhe e pa banueshme sepse është e shkatërruar në atë masë që nuk mund të përdorej për banim. Askush nuk është përgjigjur në njoftimin për kërkesë.
5. Në bazë të raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 16 Shkurt 2012 AKP-ja ka konstatuar se dokumentat e bashkangjitura në mbështetje të kërkesës nuk janë gjetur dhe

verifikimi ka qenë negativ edhe në Gjykatën e Beogradit . AKP-ja ka kontaktuar palën ankuese disa herë dhe i ka kërkuar që të paraqes deshmi tjera që tregojnë pronësinë ose posedimin e pronës së kërkuar para ose gjatë konfliktit por ai ka dështuar të sjellë dokumente tjera. Përfundimdiht me 30 Maj 2014 AKP-ja e ka kontaktuar palën ankuese dhe ajo ka konfirmuar se prona është shitur nga familjarët tjere dhe se ai do të dij vetëm çmimin e shitjes. Sipas pohimit të palës ankuese banesa është shitur nga njerka e tij M.P. dhe djali i saj N. I pyetur nga zyrtarët e AKP-së se a dëshiron ta tërheqë kërkesën ai është përgjigjur negativisht.

6. Më 18 Qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) në vendimin e vet të vërtetuar KPCC/D/R/2247/2014, e ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafet 16 dhe 17), KKPK-ja ka gjetur se paraqitësi i kërkesës ose familjarët e tij e kanë shitur pronën dhe nuk e kanë humbur posedimin sipasojë e konfliktit por si pasojë e transaksionit çka e determinon çështjen jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe rrejdhimisht kërkesa është hedhet.
7. Më 17 tetor 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimi të KKPK-së më 5 Nëntor 2014.

Pretendimet e palës ankuese:

8. Pala ankuese nuk e ka atakuar vendimin e KKPK-së por procedurat e verifikimit të dokumentave në AKP duke shprehur habinë se si është e mundur që në Gjykatën e Pejës të mos ketke dokumentacion për shitblerjen e banesës edhe pse kontrata ishte lidhur në Beograd. Për më tej ai pretendon se banesa ndodhet në Deçan kurse shitja apo tjetërsimi nga familjarët e tij është bërë në Mal të Zi kurse ai si fëmija i parë i bartësit të së drejtës ppronësore është përjashtuar nga shitja dhe me këtë i është hequr e drejta e trashigimisë parandaj ai përkundër veprimeve të paligjësme të anëtarëve të familjes ende e konsideron veten si pronar i pasurisë së babait të tij të ndjerë.

Arsyetimi ligjor:

9. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe

- nenin 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata gjeti se Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
10. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 pala ankuese ka të drejtë në urdhrin për ri-posedimin e pronës nëse dëshmon pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit të pronës ndaj pronës së kërkuar, dhe që ai nuk ishte në gjendje të ushtrojë të drejtat ndaj pronës për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlydhura me ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
 11. Pala ankuese e bazon të drejtën pronësore mbi të drejtën e babait të tij të ndjerë. Ai nuk e mohon transksionin që e kanë bërë njerka e tij dhe vëllau nga babai por e kundërshton faktin se shitja është bërë pa pjesmarrjen dhe dijen e tij.
 12. Si e tillë, Gjykata Suprem konsideron nuk është dëshmuar se është pronësi e palës ankuese në prag të konfliktit dhe nuk ka dëshmi të ketë qenë në posedim të palës ankuese e të jetë humbur si pasojë e konfliktit. Rrjedhimisht është i drejtë konstatimi i KKPK-së se prona nuk mund të jetë objekt i nje urdhëri për të marrë të drejtën pronësore ndaj asaj dhe kthimin e posedimit për arsye se pala ankuese nuk ka dëshmuar se prona i ka takuar atij dhe e ka pas në shfrytëzim para ose gjatë konfliktit apo se e ka humbur si pasojë e konfliktit
 13. Gjykata Supreme e konsideronë si të drejtë konstatimin e KKPK-së se Pala ankuese ka deshtuar të tregoi të drejtën pronësore dhe humbjen e saj menjëhere para ose gjatë konfliktit të vitit 1998-1999 dhe për këtë arsye kërkesa është hedhur si jashtë juridiksionit të KKPK-së për faktin se është tjetërsuar nga familjarët e palës ankuese.
 14. Përfundimisht Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se vendimi i ankimuar i KKPK-së ishte marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe mbi atë bazë edhe e drejta materiale edhe e drejta procedurale janë zbatuar si duhet.
 15. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it